



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 179 dt.26.12.1995

**PER**  
**DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE DHE PERFITIMIN E PAAFTESISË**  
**PER MUAJIN TETOR 1995**

Në zbatim të ligjit Nr.7710, 18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ligjit Nr.7886, dt.08.12.1994 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.7710, dt.18.05.1993”, VKM Nr.453, dt.26.09.1994 “Për dhënie e ndihmës ekonomike”, VKM Nr.311, dt.11.07.1994 “Për përfitimin e paaftësisë”, Këshilli Bashkiak, i mbledhur sot me dt.26.12.1995, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Seksionit të Mbrojtjes Shoqërore

**VENDOSI**

1. Të miratohet fondi për ndihmën ekonomike për përfitimin e paaftësisë për 2 mujorin e fundit të vitit 1995.
2. Miratohet masa e ndihmës ekonomike të plotë për çdo familje sipas relacionit.
3. Të përfitojnë ndihmë ekonomike 13.232 familje gjithsej me një fond prej 28.8 milion lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga 11 njësitë administrative.
4. Të rifuten në skemën e ndihmës ekonomike :

- Bashkim Hajdinaj, familje me 4 antarë, Nj.A.Nr.2
- Petrit Allmuça, familje me 5 antarë, Nj.A.Nr.3
- Merita Hima, familje me 2 antarë, Nj.A.Nr.3
- Naxhie Furtuna, familje me 3 antarë, Nj.A.Nr.4
- Edmond Zyberi, familje me 4 antarë, Nj.A.Nr.5
- Sefedin Nuredini, familje me 3 antarë, Nj.A.Nr.5
- Jardi Pëllumbi, familje me 3 antarë, Nj.A.Nr.11
- Fatmir Idrizi, familje me 5 antarë, Nj.A.Nr.11

5. Përfitojnë ndihmë ekonomike si raste të veçanta :

- Shpresa Braho, familje me 5 antarë, ndihmë ekonomike e pjeshme duke e afruar në nivelin maksimal, Nj.A.Nr.4.
- Luljeta Qordja, ndihmë ekonomike e plotë si familje me 1 antarë, Nj.A.Nr.6.
- Bujar Laçi, ndihmë ekonomike e plotë, si familje me 1 antarë, Nj.A.Nr.8

6. Tu ndërpritet ndihma ekonomike 163 familjeve sipas pasqyrave të bashkangjitura.

7. Të përfitojnë ndihmë ekonomike 1062 persona të paaftë me një fond prej 1.378 milion lekë.

8. Miratohet masa e ndihmës ekonomike të plotë për çdo familje për muajin nëntor 1995.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**